



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____/2020

PËR

DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.79/2017,
“PËR SPORTIN”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.79/2017, “Për sportin”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas pikës 7, të nenit 3, shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

“7/1. “Karta e tifozit” është një marrëveshje ndërmjet tifozëve dhe organizatës sportive, e cila përcakton të drejtat dhe detyrimet e organizatës sportive ndaj tifozëve të saj, si dhe anasjelltas, sanksionet bazë lidhur me rastet e shkeljes së kësaj marrëveshjeje, si dhe rregulla lidhur me mbarëvajtjen e veprimtarisë sportive, brenda e jashtë vendit.”.

Neni 2

Pikat 5 dhe 6, të nenit 7, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“5. Ndihamat apo sponsorizimet me materiale sportive, pajisje sportive, barna dhe pajisje mjekësore në funksion të sportit, për organizatat sportive dhe për Qendrën e Shërbimit të Sportit, të cilat vijnë nga institucione sportive ndërkombëtare apo çdo formë tjetër sponsorizimi, në kuadër të bashkëpunimit, nxitjes së sportit dhe rritjes së nivelit të sportit në rang

ndërkombëtar, përjashtohen nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar. Importi i barnave dhe i pajisjeve mjekësore të dhuruara bëhet me autorizim të veçantë të strukturës përgjegjëse në ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë.

6. Procedurat e përjashtimit dhe listat e materialeve e të pajisjeve sportive dhe ato mjekësore në funksion të sportit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 3

Pas nenit 13 shtohet neni 13/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 13/1

Mbështetja financiare nga njësitë e vetëqeverisjes vendore

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të mbështesin me financime klubet e tyre përkatëse sportive të futbollit të superligës, vetëm në rast se të gjithë futbollistët e klubit e kanë pagën mujore jo më të vogël se 100 000 (njëqind mijë) lekë (bruto).”.

Neni 4

Pas nenit 21 shtohet neni 21/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 21/1

Karta e tifozit

1. Karta e tifozit lëshohet nga organizata sportive, pas anëtarësimit të tifozit, sipas llojit të veprimtarisë sportive që kjo organizatë ushtron.
2. Karta e tifozit përmban rregulla lidhur me çështjet e anëtarësisë, konsultimin e informimin, aksesin dhe përdorimin e stadiumeve, sigurinë e mbrojtjen e spektatorit, tregtimin lidhur me shitjen e biletave, aktivitetet e adresuara komunitetit, si dhe rregulla të tjera, kundër racizmit, dhunës, ksenofobisë apo diskriminimit në futboll.
3. Rregulla lidhur me procedurën dhe mënyrën për pajisjen me kartën e tifozit përcaktohen në rregulloren e brendshme të organizatës sportive.”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI